



Prof. dr. Nuridin Ahmeti

(Instituti Albanologjik në Prishtinë)

Bio e shkurtër

Prof. dr. Nuridin Ahmeti (1980), doktor i shkencave të historisë dhe këshilltar shkencor në Degën e Historisë në Institutin Albanologjik në Prishtinë. Nga viti 2023, është shëf i Degës së Historisë dhe anëtar i revistës “Gjurmime albanologjike” (Seria e shkencave historike) të IA të Prishtinës. Ka botuar punime në revistat shkencore historike, si: “Gjurmime albanologjike” (Seria e shkencave historike) të IA të Prishtinës, “Studime” të AShAK në Prishtinë, “Kosova” të IH në Prishtinë, “Vjetari” të AK në Prishtinë, “Studime albanologjike” të ITSHKSh në Shkup etj. Ka marrë pjesë me kumtesa në tribuna, sesione, simpoziume dhe konferenca shkencore të organizuara në Kosovë dhe jashtë saj. Veprat autoriale të tij janë: Krerët fetarë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare në Vilajetin e Kosovës (1878-1912), IA, Prishtinë, 2011; Krerët fetarë në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare, IA, Prishtinë, 2017; Instituti Albanologjik 1953-1955, (monografi), IA, Prishtinë, 2020; Albanologjia në Jugosllavi sipas dokumenteve të arkivave të Shqipërisë 1946-1990, I-II, IA, Prishtinë, 2025.

Titulli: Shqipëria dhe Kosova gjatë viteve 1970-1980 në optikën e historianëve shqiptarë.

Abstrakt

Rithemelimi i Institutit Albanologjik dhe themelimi i Entit të Historisë në vitin 1967 në Prishtinë, si dhe organizimi i aktiviteteve të rëndësishme shkencore, si Konsulta Gjuhësore e Prishtinës, Simpoziumi për 500-vjetorin e vdekjes së Skënderbeut dhe Konferenca shkencore me rastin e 60-vjetorit të Kongresit të Manastirit (1908), të zhvilluara gjatë vitit 1968, krijuan premisat për vendosjen dhe zhvillimin e kontakteve ndërmjet intelektualëve shqiptarë nga Tirana dhe Prishtina. Një kthesë e rëndësishme në këtë drejtim shënohet pas vitit 1970, me themelimin e Universitetit të Prishtinës dhe nënshkrimin e protokollit të bashkëpunimit mësimor e shkencor ndërmjet këtij institucioni dhe Universitetit të Tiranës gjatë viteve '70. Ky bashkëpunim u shoqërua me intensifikimin e shkëmbimeve akademike dhe shkencore. Në këtë kuadër, profesorë dhe studiues nga Tirana realizuan vizita studimore në Kosovë dhe në qytete të tjera të ish-Jugosllavisë, ndërkohë që studiues nga Prishtina zhvilluan hulumtime në Tiranë dhe në qendra të tjera kërkimore në Shqipëri.

Ndër studiuesit e historisë nga Tirana që vizituan Prishtinën dhe qytete të tjera të ish-Jugosllavisë gjatë kësaj periudhe përmenden Aleks Buda, Stefanaq Pollo, Kristaq Prifti, Selami Pulaha etj. Në anën tjetër, ndër studiuesit nga Prishtina që zhvilluan vizita dhe hulumtime në Shqipëri veçohen

Ali Hadri, Hasan Kaleshi, Skënder Rizaj, Ismet Dermaku, Muhamet Pirraku, Zekeria Cana, Bedrush Shehu etj.

Studiuesit e të dyja qendrave akademike jo vetëm që mbanin ligjërata në Tiranë dhe Prishtinë, por gjithashtu angazhoheshin në hulumtime në arkiva dhe biblioteka përkatëse, rezultatet e të cilave i përmbledhnin në relacione dhe raporte zyrtare. Këto dokumente përmbajnë jo vetëm të dhëna shkencore, por edhe reflektime, qëndrime dhe përshtypje mbi mjedisin akademik dhe shoqëror, si dhe mbi kontaktet ndërpersonale të realizuara gjatë këtyre vizitave.

Duke u mbështetur në dokumentacionin e hulumtuar, ky punim analizon deklaratat dhe raportet e dy grupeve të studiuesve nga të dyja qendrat, me synim evidentimin e qëndrimeve dhe perceptimeve të tyre, të cilat ofrojnë të dhëna me interes të veçantë për studimin e bashkëpunimit shkencor shqiptaro-shqiptar gjatë kësaj periudhe.

Fjalë kyçe: *studiues, historianë, bashkëpunim shkencor, Tiranë, Prishtinë, hulumtime, arkiva, dokumentacion.*